

01. tragjedia fillon

« **Prandaj, ashtu si me ane te nje njeriu te vetem mekati hyri ne bote dhe me ane te mekatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek te gjithenjerezit, sepse te gjithë mekatua n.** » ROMAKET 5 :12

QELLIMI

Fokusim ne origjinen e njeriut dhe te mekatit, si dhe ne rezultatet e renies. Te kuptohen me thellesisht ngjarjet qe nga historia e hershme e deri ne ditet e sotme, si dhe ndikimin e tyre ne jetet tona personale.

HYRJA

Zanafilla na jep nje pikturë te origjines njerezore, renies se NJERIUT si dhe planin e Perendise per shpetimin e tij. Per shkak se Bibla eshte Fjala e frymëzuar e Perendise, ne mund te mbeshtetemi ne Zanafille per te qene krejtësisht ne sakte deri ne detaj.

Sic e shohim neper te gjithë Biblen, njeriu ishte krijuar per te pasur nje mardhenie miqesie me Perendine, por per shkak te vullnetit te tij te genjyer, dhe ME DESHIREN E TIJ, njeriu vendosi te jetoje ne menyre te vecuar nga Perendia. Kjo eshte ajo qe Bibla e cileson me fjalen MEKAT.

Si rezultat i renies se Adamit, te gjitha krijesat iu nenshtroan renies. Apostulli Pal shkruan : « *Prandaj, ashtu si me ane te nje njeriu te vetem mekati hyri ne bote dhe me ane te mekatit vdekja, po ashtu vdekja u shtri tek te gjithenjerezit, sepse te gjithë mekatua n.* » ROMAKET 5 :12

Ky ishte veprimi i pare ne tragjedine njerezore qe shenoi fillimin e te gjithë asaj qe pason. Nese nuk do te kishte mekat, automatikisht nuk do te kishte as nevojë per PENDIM, dhe njekohesisht nuk do te kishte nevojë per Biblen qe te na tregonte rrugen e pendimit.

STUDIMI

Origjina e Njeriut

1. Si u krijua bota ku jetojme (Zan 1)
2. Cila ishte gjendja botes dhe e cdo gjeje ne te ne ate peridhe (Zan 1 :10, 12, 18, 21, 25)
3. Si u krijua njeriu i pare (Zan 1 :27)
4. A ishte Adami intelogjent.. apo ishte « njeri i shpelles » (Zan 2 :20)
5. Si u krijua gruaja e pare (Zan 2:21-22)

Origjina e Mekatit

1. Cila ishte mareveshja e pare e Njeriut me Perendine (Zan 1 :28-30)
2. Cila ishte mardhenia e Njeriut me Perendine (Zan1:28)
3. Cilat ishin karakteristikat e Satanit, kur iu prezantua Eves si gjarper (Zan 3:1-5). Si iu prezantohet ai juve sot?
4. Si p yeti Satani (Zan 3:1). Si u pergjigj Eva (Zan 3:2-3). Cfare kishte thene Perendia (Zan 2:17)
5. Sipas 1 Gjonit 2:16, analizo TUNDIMIN dhe rreshto 3 perberjet e tij tek Zanafilla 3:6
6. Perse ishte GABIM per Adamin dhe Even te hanin nga kjo peme (Zan 2:16-17)

Rezultati i Mekatit

1. Cili ishte rezultati i Mekatit, Burrit dhe Gruas (Zan 3:7-8)
2. Si ndryshoi mardhenia miqesore e njeriut me Perendine (Zan 3: 8-10)
3. Cili ishte premtimi i Perendise per shpetimin e njerezimit (Zan 3 :15) - *krahaso Mateun 1 :18-23*

APLIKIMI

A – Si ndikon mekati i Adamit dhe Eves tek ne sot (Rom 5:12)

B – Lexo Romakeve 3:23 dhe 6:23. Pershkruaj cfare vdekja dhe ringjallja e Jezus Krishtit do te thote per ju.